



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 924 Prot.

Tiranë, më 27.06 2019

VENDIM Nr. 167 datë 25.06.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.06.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Instalim antene, hapje rruge e nevojshme për në Stacion me gjatësi 412.5 m, ndërtimi i Linjës ajrore e tensionit të ulët me gjatësi 574.5m për Stacionin e telefonisë celulare të shoqërisë Vodafon Albania sh.a., të emëruar si site "1246 Gërmenji", realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Instalim antene, hapje rruge e nevojshme për në Stacion me gjatësi 412.5 m, ndërtimi i Linjës ajrore e tensionit të ulët me gjatësi 574.5m për Stacionin e telefonisë celulare të shoqërisë Vodafon Albania sh.a., të emëruar si site "1246 Gërmenji", realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Të vijojnë punimet e gërmimit të projektit të sipërpërmendur nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al